

NJOFTIM
Nr. 2750/1, datë 5.7.2022

**PËR SHPALLJEN E NJË VENDI VAKANT PËR POZICIONIN E SPECIALISTIT
TË IT-së NË KOMISIONIN E PAVARUR TË KUALIFIKIMIT, ME AFAT 6 DERI NË
12 MUAJ**

Në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar, që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Specialistit të IT-së në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: III-b.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

1. Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master shkencor” në Inxhinieri Informatike, Informatikë, Teknologji Informacioni etj.;

2. Të ketë 2 vjet eksperiencë pune në fushën e teknologjisë së informacionit;

3. Të ketë njohuri shumë të mira në administrimin e sistemeve, si: *Active Directory, Outlook Mail Client*;

4. Të ketë njohuri bazë mbi pajisjet e rrjetit dhe infrastrukturën e rrjetit;

5. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;

6. Preferohet të jetë i pajisur me CSP;

Kushte të përgjithshme:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t’u pajisur me certifikatë sigurie, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

- Ndaj tyre të mos jetë nisur procedim penal, të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale.

- Ndaj tyre të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.

- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur e punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;

2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;

3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune) (originale ose të noterizuar);

4. Dëshmi penaliteti;

5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim;

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda datës 14 korrik 2022 pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në adresën: Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, Zyra e Protokollit, nga e hëna–të premte, ora 08:30–17:00, ose nëpërmjet postës elektronike në adresën: info@kpk.al, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.